

Mr. Isuf AHMETI

QYTETET E KOSOVËS SIPAS EVLIA ÇELEBIUT

Udhëpërshkruesi turk Evlia Çelebiu një kohë të gjatë ishte harruar në shkencën turke e evropiane. Thjesht, është për t'u habitur se si biografët, historiografët dhe kronistët e vjetër turq nuk e përmendin fare. I vetmi është Ekrem Reshad Koçu, që për të ka gjetur një shënim të shkurtër në një dorëshkrim të vjetër.¹

Ky udhëpërshkrues i madh turk u lind në Stamboll në lagjen Kasim Pasha në Un-Kapanë më 10 muharrem 1020 (25 mars 1611), siç e thotë vetë në udhëpërshkrimin e tij² dhe siç ka pohuar më herët Hammer, dhe jo në vitin 1025 / 1616 siç e ka gjetur në Sejahetname Glisha Elezoviq.³

Evlia Çelebiu rrjedh nga një familje e vjetër turke, të parët e së cilës më herët kanë jetuar në qytetin Kutahi (Anadoll). Prej aty pas pushtimit të Stambollit më 1453 u shpërngulën në këtë qytet ku stërgjyshi i Evliut fitoi një paluajtshmëri të madhe në lagjen e sotme Kasim- Pasha në Un- Kapanë.⁴

Ky udhëpërshkrues është i njohur me emrin Evlia Çelebi, apo Evlia Efendi, por emri i tij i vërtetë dhe i plotë është Evlia Çelebi ibn Dervish Mehmed Zilli, ashtu siç thuhet qartë në shumë pjesë të "*Sejahatnamesë*"⁵, e jo Evlia Mehmed Zilli ibn Dervish, siç është në titujt e gjashtë fashikujve të parë të botuar të udhëpërshkrimit dhe siç kanë shkruar më parë shumë shkencëtarë turq dhe perëndimorë. Çelebi, përkatësisht efendi, janë emra

¹ Hazim Šabanović, *Putopis Evlija Čelebi*, Sarajevo, 1967, f. 9; Resad Ekrem Koçu, *Evliya Çelebi Seyahatnamesi (hulasa)*, I, rresht. 4., sipas C. Baysunu në Islam Ansiklopedisi I, f. 410.

² Sejahatnama I, 212.

³ Gliša Elezović, *Evlija Čelebija, (svetski putnik i putopisac)*. Srpski književni glasnik (SKG), nova serija, knj. XXXIV, nr. 7, f. 516.

⁴ H. Šabanović, *Putopis...*, f. 21.

⁵ Sejahatname I, 212, 218, 244, 424; III, 442, 443; VI, 226; H. Šabanović, *Putopis ...*, f. 21.

klasorë që në atë kohë u janë dhënë njerëzve të arsimuar, dhe të dy këta kanë domethënien “ *zotëri* “. ⁶

Pas të gjitha këtyre udhëtimeve gjatë së cilave Çelebiu mësoi dhe përjetoi shumë, ditët e pleqërisë ua kushtoi sistemimit dhe redigjimit të udhëpërshkrimeve të tija të njohura. Për ato ditë pleqërie të tij nuk dihet pothuaj asnjë e vërtetë. Nuk dihet me saktësi madje as kur dhe ku vdiq. Ngjarja e fundit për të cilën flitet në *Sejihatname* rrjedh nga vitit 1862, ⁷ prandaj me mjaft siguri mund të pohohet se pas vitit 1676 nuk ka jetuar gjatë. Nuk dihet as ku është varrosur. Mehmed Tahir ⁸ thotë se varri i tij gjendet në Stamboll, në të cilin deri vonë është parë edhe mbishkrimi por për këtë nuk ka të dhëna të sigura.

Udhëpërshkrimi i Evlia Çelebiut me të cilin ai fitoi famë botërore është i njohur me emrin “ *Sejihatnameja* “ (Udhëpërshkrimi). Kështu edhe vetë Evlia Çelebiu e quan më së shpeshti veprën e tij. ⁹ Botimi i Stambollit mban titullin Evliya Çelebi Seyahatnamesi (Udhëpërshkrimi i Evlia Çelebiut). ¹⁰ Mirëpo, nuk përjashtohet mundësia që Evlia Çelebiu veprës së tij t’ia ketë dhënë titullin Tarih-i sejjah (Historia e udhëtarëve), siç është rasti me dorëshkrimin e Vjenës dhe siç del nga titulli i redaktimit të shkurtër të atij dorëshkrimi. ¹¹

Më herët A. Shopov kishte përkthyer në bullgarisht përshkrimin e udhëtimit të Evlia Çelebiut nga Novi Pazari deri në Sofje (*Sejihatnameja fashik*. V, 544-569) dhe një pjesë të përshkrimit të udhëtimeve në “ Dhjetë kadillëqe “ të elajetit të Rumelisë (V, 569-588). ¹² Pas Luftës së Dytë Botërore, në veçanti prej kur turqit botuan katër fashikujt e fundit të *Sejihatnamesë*, ajo bëhet objekt studimi i shumë turkologëve e osmanistëve të njohur. Atëherë, në bazë të *Sejihatnamesë* ose lidhur me të, u paraqitën një sërë trajtimeve e studimesh nga Richard Hartman ¹³, W. Björkmann ¹⁴, e shumë të tjerë. ¹⁵

⁶ H. Šabanović, *Putopis* ..., f. 22.

⁷ Richard F. Kruetel, *Im Reiche des Goldenen Apfels*, Graz-Wien-Köln, 1957, f. 23; H. Šabanović, *Putopis* ..., f. 40.

⁸ M. Tahir Brusali, *Osmanli müellifleri*, Istanbul, III, 1343, f.23.

⁹ *Sejihatname*, V, 390; H. Šabanović, *Putopis* ..., f. 41

¹⁰ Evliya Çelebi, *Seyahatnamesi*, IX, X.

¹¹ H. Šabanović, *Putopis* ..., f. 41.

¹² Šopov, *Periodičesko Spisanie na b'lgarskoto družestvo*, Sofija 1901. knj. LXII, sv. 3, str. 161-194. Up; Gl. Elezović u glasniku Jugoslovenskog profesorskog društva (GJPD) XI, 1931, f.185.

¹³ Richard Hartman, *Zu Ewlija Tschelebis Reisevege in Albanian*, Berlin, 1930; H. Šabanović, *Putopis* ..., f. 14.

¹⁴ W. Björkmann, *Ofen zur Türkenzeit*, Hamburg, 1920.

¹⁵ H. Šabanović, *Putopis*..., f. 14.

Vepra e udhëpershkruesit turk Çelebiut nga të gjitha pikëpamjet, shoqërore, ekonomike dhe politike, është një thesar i begatshëm për të ndriçuar historinë e popullit shqiptar.

Çelebiu trajton historinë e vendit, gjeografinë, industrinë, kulturën, arkitekturën, karakterin, zakonet, jetën shoqërore, racën njerëzore, gjuhën, besimin, institucionet, gojëdhënat, legjendat, përrallat, shkurt: çdo gjë që ka parë dhe ka dëgjuar.¹⁶ Për turqit kjo vepër është një thesar i pashterrshëm. Mirëpo, për kombet e tjera ajo është një dokument historik me rëndësi të shumëfishtë.¹⁷

Shumë dijetarë të mëdhenj kanë bërë komente për udhëpërshkrimet e Çelebiut. Një ndër ta është edhe prof. Mamhenyn Vambéry, anëtar i Akademisë së Budapestit, i cili thotë se Evlia Çelebiu ka përshkruar të gjitha ato që ia ka zënë syri¹⁸ dhe ai është më i madhi i të gjithë turistëve mysliman të mesjetës, duke ua kaluar edhe Meseudiut, Ibni Fadlanit, Idrisiut, Ibni Betutës etj.¹⁹ Ndërkaq, komenti i prof. Turk Nexhip Asimit është: “ *Pyetjes se kush di më shumë, jetëgjati apo shëtitësi, osmanlinjtë i janë përgjigjur Shëtitësi* ”. Mes tyre ka pasur shumë shëtitës, megjithatë kanë qenë të paktë ata që i kanë shkruar përshtypjet e udhëtimeve të veta. Një ndër ta, i cili ka arritur lavdinë e tij e të kombit të vet, është Evlia Çelebiu.²⁰ Krahës Udhëpërshkrimit të tij të madh, Evlia Çelebiu ka shkruar edhe një vepër me titull Shikkanameja²¹, por ajo deri tani nuk është gjetur dhe as nuk dihet se ç’ka përmbajtur.²²

Po thuaj gati i tërë fashikulli i gjashtë i Sejahatnamesë është me përshkrime të udhëtimeve të Evlia Çelebiut nëpër territorin e Ballkanit.

Evlia Çelebiu në veprën e tij përmend disa qytete të Kosovës. Sipas defterit kadastral osman të vitit 1590, Sanxhaku i Prizrenit kishte 5 nahije: e Prizrenit me 24 fshatra, e Hoçës me 96 dhe e Bihorit me 151 fshatra.²³ Burimet osmane theksojnë se Sanxhaku i Prizrenit më 1634 dhe më 1639²⁴ ishte sanxhak më vete. Ndërkaq, më 1629²⁵ dhe më 1641²⁶ ai përmendet si

¹⁶ Evlia Çelebi, *Shqipëria 350 vjet më parë (Përkthyer nga Sali Vuçiterni)*, Tiranë, 2000, f. 7.

¹⁷ Po aty, f. 7.

¹⁸ Po aty, f. 12.

¹⁹ Po aty, f. 12.

²⁰ Po aty, f. 10.

²¹ Sejahantama I, 385; H. Šabanović, *Putopis ...*, f. 51.

²² H. Šabanović, *Putopis ...*, f. 51.

²³ Ayni Ali, *Kavanin-i al-i Osman der Halusa-i mezamin-i divan Istanbul 1280 (1854)*, f. 17; Mr. Marjan Prenkaj, *Prizreni dhe rrethina në shekullin XIX-XX*, Instituti i Historisë, Prishtinë, 1998, f. 15.

²⁴ Skender Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*, Prishtinë, 1982, f. 59.

²⁵ M. Sokolovski, *Turski dokumenti*, seria e parë, t. III, Skopje, 1969, Dok. 245.

sanxhak në kuadër të Ejaletit të Rumelisë. Këtë e pohon edhe një dokument tjetër osman i vitit 1646.²⁷ Po ashtu, sipas Ali Çaushtit, Sanxhaku i Prizrenit më 1653 ishte nën administrimin e këtij Ejaleti.²⁸

Në fillim të shekullit XVII (1609/10) Kosova në pikëpamje administrative ishte në kuadrin e dy ejaleteve. Pjesa në veri nga Mitrovica deri te Ajruqa ishte në kudër të Ejaletit të Bosnjës, kurse rrafshi Kosovës që përfshinte Vushtrinë, Prishtinën, deri te Kaçaniku, i takonte Sanxhakut të Vushtrisë, në kuadrin e Ejaletit të Rumelisë. Kuptohet, edhe Sanxhaku i Prizrenit dhe ai i Dukagjinit përfshiheshin në Ejaletin e Rumelisë.²⁹

Në gjysmën e shekullit XVII Sanxhaku i Prizrenit përbëhej prej 6 kadillëqeve: i Prizrenit, Suharekës, Hasit të Prizrenit, Hoçës, Bihorit dhe i Tërgovishtës.³⁰ Ndërkaq, më 1667 ai kishte këto kadillëqe: i Hoçës, Bihorit, Tërgovishtës, Suharekës, Rahovecit dhe i Hasit të Prizrenit.³¹

Çelebiu pohon se qyteti i Prizrenit është vend që gjendet pas maleve në perëndim të Shkupit nga i cili është larg dy ditë udhë në këmbë.³² Mirëpo, nuk jep më tepër të dhëna për Prizrenin dhe për Pejën, përpos në disa vende ku i përmend kalimthi. Nga kjo kuptojmë se Çelebiu gjatë udhëtimeve të tij nuk ka pasur fat të kalojë nëpër këto dy qytete të mëdha dhe të njohura.

Për Gjakovën Çelebiu jep një përshkrim të shkurtër, duke theksuar se ai është qytet i bukur, me klimë të këndshme, me ajër dhe ujë të mirë, me njerëz të bukur dhe të dashur.³³ Sipas tij, qyteti ka 2000 shtëpi, disa xhami të vogla (mesxhide) dhe dy të tjera të mëdha, një hamam të bukur, hane dhe 300 dyqane të mbushura me mallra të ndryshme.³⁴ Evlia Çelebiu, që vizitoi

²⁶ V. Boškov, *Turski dokumenti*, seria e parë, t. IV, Skopje, 1972, dok. 89; Mr. Marjan Prenkaj, *Prizreni dhe rrethina në shekullin XIX-XX*, Instituti i Historisë, Prishtinë, 1998, f. 15.

²⁷ Selami Pulaha, *Qëndresa e popullit shqiptarë kundër sundimit osman nga shek. XVI deri në fillim të shek. XVIII*, Dokumente osmane, Tiranë, 1978, dok. 61.

²⁸ Hamid Hadžibegić, *Rosprava Ali Čauša iz Sofije o timarskoj organizaciji u XVII veka*, GZM, BIH, Sv. II, Sarajevo, 1949, f. 178; Mr. Marjan Prenkaj, *Prizreni dhe rrethina në shekullin XIX-XX*, Instituti i Historisë, Prishtinë, 1998, f. 15.

²⁹ Seknder Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*, Prishtinë, 1982, f. 56.

³⁰ Hadži Kallfa ili Katib Čelebija, *Turski geograf XVII veka o Balkanskom poluostrvu*, spomenik SKA SVIII, Beograd, 1892, f. 57; Mr. Marjan Prenkaj, *Prizreni dhe rrethina në shekullin XIX-XX*, Instituti i Historisë, Prishtinë, 1998, f. 15.

³¹ Skender Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*, Prishtinë, 1982, f. 59; Mr. Marjan Prenkaj, *Prizreni dhe rrethina në shekullin XIX-XX*, Instituti i Historisë, Prishtinë, 1998, f. 16.

³² H. Šabanović, *Putopis* ..., f. 287.

³³ H. Šabanović, *Putopis*..., f. 338; Dr. Ali Hadri, *Gjakova në LNÇ*, Prishtinë, 1974, f. 18.

³⁴ Dr. Ali Hadri, *Gjakova në LNÇ*, Prishtinë, 1974, f. 18; H. Šabanović, *Putopis*..., f. 338.

këtë qytet më 1662, shkruante se në Gjakovë ekzistonin njëmijë zeje të ndryshme.³⁵ Kështu, zejtaria në Gjakovë shekuj me radhë ishte njëra ndër degët më të zhvilluara të ekonomisë. Prodhimet zejtare të Gjakovës ishin të njohura jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë.³⁶ Në këtë qytet ishin zhvilluar thuajse të gjitha llojet e zejeve.³⁷ Këto të dhëna dëshmojnë për zgjerimin e qytetit për një kohë shumë të shkurtër, dmth. Gjakova në atë kohë ka qenë qytet me kuptimin e plotë të fjalës.³⁸

Për Mitrovicën ai shkruan se në këtë qytet vjen nga një udhëtim në Hungari, kalon nëpër Bosnjë e shkon në Shqipëri. Ky qytet është pushtuar nga sulltan Murati Hodavendiçari, i cili në betejën e Kosovës preu disa mijëra koka të të pafeve (ushtarë të forcave të koalicionit ballkanik. I.Ahmeti). Në një moment, derisa po përkujdesej për të plagosurit dhe të vrarët, në befasi u sulmua dhe u vra nga një ushtar i koalicionit ballkanik, i quajtur Millosh Kopiliqi.³⁹

Në gjysmën e dytë të shekullit XVII ndodhi një zhvillim më i madh ekonomik i Mitrovicës. Qysh në vitin 1651, sipas të dhënave që ka lënë udhëpërshkruesi Evlia Çelebiu, Mitrovica ka qenë një vendbanim i zhvilluar me 300 shtëpi të mbuluara me tjegulla, një xhami, një han, një hamam dhe disa dyqane. Kasabaja e Mitrovicës gjendej pranë teqesë së Mustafa-babës, ku jetonin bektashinj të varfër, që u bënë konak udhëtarëve.⁴⁰ Mitrovica është në perëndim të fushës së Kosovës. Kështjella e saj është në formë vezake, prej guri. Kjo fortesë ka vetëm një portë. Brenda saj nuk ka ndërtesa të mira.⁴¹ Pastaj Çelebiu udhëtoi, siç thotë, për në fushën e pasosur të Kosovës, dhe arriti në Vushtri.

Evlia Çelebiu në vitin 1661 e përmend Vushtrinë si qendër të Sanxhakut dhe vë në pah se me kazatë e veta (Prishtinën, Novobërdën) gjendet në Ejaletin e Rumelisë.⁴² Sipas regjistrimit të kadillëqeve të Rumelisë më 1667 në përbërjen e Sanxhakut të Vushtrisë janë llogaritur këto kadillëqe:

³⁵ Dr. Jusuf Bajraktari, *Gjakova me rrehtinë (1878-1912)*, Instituti i Historisë, Prishtinë, 1998, f. 48; Hasan Kaleshi, *Kosova e Metohija në udhëpërshkrimet e Evlia Çelebisë*, Përparimi, nr. 7-8, Prishtinë, 1955, f. 434.

³⁶ Dr. J. Bajraktari, *Gjakova ...*, f. 47-48.

³⁷ Po aty, f. 48.

³⁸ Dr. A. Hadri, *Gjakova ...*, f. 18.

³⁹ Po aty, f. 266-267; Evlia Çelebi, *Shqipëria 350 vjet më parë (Përkthyer nga Sali Vuçiterni)*, Tiranë, 2000, f. 116.

⁴⁰ *Mitrovica dhe rrethina*, Mitrovicë, 1979, f. 77; H. Šabanović, *Putopis...*, f. 266-267.

⁴¹ Evlia Çelebi, *shqipëria 350 vjet më parë (përkthyer nga Sali Vuçiterni)*, Tiranë, 2000, f. 116; H. Šabanović, *Putopis...*, f. 267.

⁴² E. Çelebia, *Putopis*, II, Sarajevo, 1957, f. 23, 26, 59.

Prishtina, Prokupla, Novobërda, Morava, Janjeva dhe Koriça (duhet të jetë Kara Tomlu – Karadaku i Shkupit).⁴³

Vushtrria është pushtuar në vitin 792 (1391) nga Gazi Hodovendiçari, i cili shkatërroi dhe shembti fortesën. Vushtrria është qendra e sanxhakbeut (prefektit) dhe varet nga Ejaleti i Rumelisë. Ka Allajbej dhe Çeribashë. Në bazë të ligjit ky ejalet nxjerr katër mijë ushtarë. Këtu është myftiu, nekibi, kadiu me 150 akçe.⁴⁴ Përveç këtyre, në Vushtri në radhët e parisë dhe fisnikëve bëjnë pjesë edhe këto autoritete: çehajai i spahinjve, serdari i jeniçerëve, financieri, agai i haraçit etj.⁴⁵ Çelebiu shton se në Vushtri shëtit këto lagje: lagjen e Shehiti të Allajbeut, të vjetrën, të sipërmen, si dhe lagjen e poshtme. Qyteti sipas tij kishte 2 mijë shtëpi dykatëshe prej guri dhe të mbuluara me tjegulla.⁴⁶ “Në treg janë vakëfet e Hodavendiçarit, xhamia e vjetër, medreseja dhe teqeja. Afër ndërtesës së gjyqit është edhe një banjo e errët. Tregu është i vogël.⁴⁷ Banorët e qytetit janë rumelias (ballkanas vendës). Nuk flasin boshnjakisht (që nënkupton se nuk flasin sllavisht - I.Ahmeti), flasin shqip dhe turqisht”.⁴⁸ Hasi i sanxhakbeut të Sanxhakut të Vushtrisë, në kohën e Evlia Çelebiut kapte 205.000 akçe.⁴⁹

Vushtrria, që nga koha e Evlia Çelebiut, pas një përparimi të dukshëm që kishte arritur në gjysmën e parë të shekullit XVI, kishte filluar t’i tregonte përsëri shenjat e rënies. Dmth. gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII Vushtrria kishte përjetuar disa ngritje e rënie. Kështu, më 1671 fra-Bernardini në Vushtri kishte hasur edhe 4 familje të besimit katolik me 30 frymë.⁵⁰ Në vazhdim E. Çelebiu shkruan se nga Vushtrria në drejtim të Gjylapit (Llapit), nëpër Fushë-Kosovë arrin në Tyrben e Sulltan Muratit. Ai më pas thotë se kjo tyrbe nuk kishte kujdestarë e shërbëtorë dhe përmend të dhënë se pranë saj ndodhen varrezat e rreth 10 mijë dëshmorëve e shenjtoreve. Çelebiu më pas vazhdon udhëtimin në drejtim të Prishtinës.⁵¹

⁴³ Skender Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*, Prishtinë, 1982, f. 57.

⁴⁴ Evlia Çelebi, *Shqipëria 350 vjet më parë (përkthyer nga Sali Vuçiterni)*, Tiranë, 2000, f. 117; H. Šabanović, *Putopis...*, f. 273.

⁴⁵ Po aty.

⁴⁶ Po aty.

⁴⁷ Po aty.

⁴⁸ Dr. Seknder Rizaj, *Disa të dhëna për Vuçiternën në kohën e administrimit osman*, “Kosova” Instituti i Historisë së Kosovës, nr. 13-14, Prishtinë, 1985, f. 391-392; Evlia Çelebi, *Shqipëria 350 vjet më parë (përkthyer nga Sali Vuçiterni)*, Tiranë, 2000, f. 118; H. Šabanović, *Putopis...*, f. 273-275.

⁴⁹ Evlia Çelebi, *Seyahatnamesi*, 1-2, Istanbul, 1976, f. 129; Dr. S. Rizaj, *Disa ...*, f. 392.

⁵⁰ Dr. S. Rizaj, *Disa ...*, f. 392.

⁵¹ Evlia Çelebi, *Shqipëria 350 vjet më parë (përkthyer nga Sali Vuçiterni)*, Tiranë, 2000, f. 118; H. Šabanović, *Putopis...*, f. 275.

Sipas tij, edhe Prishtina është pushtuar nga Hodavendiçari,⁵² i cili e shkatërroi dhe shembi menjëherë kështjellën e saj. Prishtina sipas tij ndodhet në lindje të Fushë-Kosovës, kishte dy mijë e gjashtëdhjetë shtëpi dykatëshe prej guri, të mbuluara me tjegulla dhe të rrethuara me oborre të gjera e kopshte të bukura. Qyteti kishte një kadi me 150 akçe, i cili rregullisht kishte pesë qese në vit.⁵³ Autoritetet e Prishtinës ishin çehajai, serdari i jeniçerëve etj. Pallati i Allabeut dhe i gjykatës ishin me famë,⁵⁴ ndërsa në xhaminë e pazarit ka shumë lëvizje njerëzish.⁵⁵

Sipas Çelebiut në Prishtinë kishte njëmbëdhjetë hane, ndër të cilat më me emër është hani i Haxhi Beut. Qyteti kishte dy banjo, njëra është banjoja e Fatihut në pazar e tjetra është banjoja e vjetër. Në një qoshe të banjës sa Fatihut është varrosur një i shenjtë, prandaj kjo banjë quhet si e shenjtë dhe në të bëhen vizita.⁵⁶ Në Prishtinë ka edhe 300 dyqane, të cilat për këtë qytet janë pak.⁵⁷ Çelebiu më pastaj vazhdon rrugën nga Prishtina dhe mbërrin në fshatin Dobratin, një fshat me afro 500 shtëpi.⁵⁸ Nga ky fshat në drejtim të lindjes arritëm në qytetin e Kaçanikut.⁵⁹ Këtu, në gojë të grykës e në breg të Lebenatit, ngadhënjyesi i Jemenit Sinan Pasha, ka ngritur një kështjellë. Kjo kështjellë e bukur me formë katrore dhe një perimetër 800 hapa, ndodhet në një luginë me pengime të forta. Ajo ka disdarin, pesëdhjetë ushtarë, dy topa e një portë. Brenda saj ndodhen dyzet shtëpi që shërbejnë për banesat e ushtarëve.⁶⁰

Shtëpitë aty janë të mbuluara me tjegulla. Ka vetëm një xhami, një teqe bektashinsh, një shkollë e një han të madh, një banjë të vogël afër shkëmbit. Nuk ka treg, meqë Shkupi është shumë afër. Ka një kadi me 150 akçe. Detyra e kadiut trashëgohet si dhuratë nga shtëpia e Vejsi Efendi Shkupjanit.⁶¹ Më pastaj Evlia Çelebiu vazhdoi rrugën për në Shkup pasi vizitoi Tyrben e Kërklerëve.⁶²

⁵² H. Šabanović, *Putopis...*, f. 275.

⁵³ Po aty, f. 275.

⁵⁴ Po aty, f. 276.

⁵⁵ Evlia Çelebi, *Shqipëria 350 vjet më parë* (përkthyer nga Sali Vuçiterni), Tiranë, 2000, f. 119.

⁵⁶ Po aty, f. 119; H. Šabanović, *Putopis...*, f. 276.

⁵⁷ Po aty, f. 119.

⁵⁸ Po aty, f. 276.

⁵⁹ Po aty, f. 276.

⁶⁰ Evlia Çelebi, *Shqipëria 350 vjet më parë* (përkthyer nga Sali Vuçiterni), Tiranë, 2000, f. 119-120.

⁶¹ Po aty, f. 120.

⁶² H. Šabanović, *Putopis...*, f. 278.

Këtë krahinë e ka pushtuar Gazi Evranos beu në kohën e Jelldërem Pajazitit,⁶³ i cili e pëlqeu tepër klimën e këtij vendi.⁶⁴ Ai qëndronte shpesh herë në Shkup me ushtrinë e tij dhe prej këndej niste fushatat për të pushtuar vende të tjera.⁶⁵

Shkupi ndodhet përmbi një fushë, e cila shtrihet në dy anët e lumit Vardar. Kështjella dhe qyteti janë në perëndim të Vardarit. Qyteti ka disa mijëra shtëpi guri dhe ndahet në shtatëdhjetë lagje.⁶⁶

Sipas organizimit të Sylejman Khanit, Shkupi është kryeqendra e sanxhakbeut, i cili e administron dhe ka në dispozicion 500 ushtarë.⁶⁷ Kur është e nevojshme ai merr pjesë në luftë. Të ardhurat e tij vjetore përbëhen nga dhjetë qese. Shkupi ka 255 timare e zeamete⁶⁸ si dhe është në gjendje të nxjerrë për rast lufte deri pesë mijë ushtarë.⁶⁹

Autoritetet e vendit janë: Allaj beu, Çeri Bashi, Juz Bashi (kapiteni), Sheh Islami, Nekibul Eshrefi. Sipas ligjit mbretëror, është kryemyfti me 500 akçe. Ka 350 fshatra që i sigurojnë Mullahut të ardhura vjetore afro njëzet qese. Mullallëku ka në varësi pesë nënmyfti dhe dyzet deri pesëdhjetë kadilerë. Veç këtyre, ka edhe çehajain e spahinjve, serdarin e jeniçerëve, disdarin e kalasë me 300 ushtarë.⁷⁰

Shkupi ka edhe baxhdarxhiun, i cili nxjerr taksën e baxhës nga malli që importojnë karvanet.⁷¹ Në shkup nuk ka zyrë dogane, sepse taksa doganore nxirret në Selanik, Beograd etj.⁷²

Shkupi, gjithashtu, ka një kala të përforcuar në dy rrafshje e me banorë të njohur. Muret e kësaj kalaje përbëhen nga gurë të lëmuar me shumë elegancë.⁷³ Kalaja e lartë ndodhet mu në qendër të qytetit dhe ka formë pesëkëndore. Muret e saj janë pesëdhjetë kut të lartë. Kalaja është e zbukuruar me shtatëdhjetë kulla.⁷⁴ Qyteti ka 2 mijë dyqane të bukura. Nga kalaja mund të sigurosh një fushëpamje mjaft të mirë, pasi rreth saj nuk ka pengesa të larta dhe mund të shohësh gjithë hapësirën fushore. Në perëndim

⁶³ Po aty, f. 278; Evlia Çelebi, *Shqipëria 350 vjet më parë (Përkthyer nga Sali Vuçiterni)*, Tiranë, 2000, f. 120.

⁶⁴ Po aty, f. 120.

⁶⁵ Po aty, f. 120.

⁶⁶ Po aty, f. 120.

⁶⁷ H. Šabanović, *Putopis...*, f. 278-279.

⁶⁸ Seyahatnama, I, f. 195.

⁶⁹ H. Šabanović, *Putopis...*, f. 279.

⁷⁰ Evlia Çelebi, *Shqipëria 350 vjet më parë (Përkthyer nga Sali Vuçiterni)*, Tiranë, 2000, f. 121.

⁷¹ Po aty, f. 121.

⁷² Po aty, f. 122.

⁷³ Po aty, f. 122.

⁷⁴ Po aty, f. 122.

të saj është lumi i Vardarit, në breg të të cilit ka një kullë uji të lidhur me kalanë nëpërmjet një kanalizimi të gurtë.⁷⁵ Portën e ka meremetuar sulltan Murati i Muhamet Khanit në vitin 1452 / 856 h. Brenda kalasë ka njëqind shtëpi ushtarësh, depo për municion e ushqim, si dhe pak topa.⁷⁶

Qyteti ka dhjetë mijë e gjashtëqind shtëpi dykatëshe, të gjitha prej guri e shumë të bukura, të mbuluara me tjegulla të kuqe. Pallatet më të famshme janë ai i Mahmut Pashës, i Emir Pashës, i Koxha Serdarit dhe i Zeçan Zades.⁷⁷ Shkupi ka edhe dyzet e pesë xhami e pesëdhjetë e pesë mesxhide. Më të përmendurat ndër to janë xhamia e Hynqarit pranë orës dhe Jahja Pashës në lagjen e poshtme.⁷⁸ I tërë ujët e Shkupit vjen nga malet e Kaçanikut dhe bashkohet me Vardarin, uji vjen nga malet e Prizrenit dhe kalon nëpër Shkup, Qyperli, Karaferi dhe derdhet në gjirin e Selanikut. Në Shkup ka njëmijë mullinj e shumë banjo, ndër të cilat më me emër janë ajo e Vajzave, banja e bojaxhinjve dhe banja e Isa beut. Në Shkup ka edhe njëmijë e ca banjo familjare.⁷⁹

Tregu ka 2 mijë e 150 dyqane guri të stolisura me kube e me qemer. Pëlhurtarët, qendistarët, çadërxhinjtë, janë tregje të hijshëm e të shtruar me kalldrëm të pastër.⁸⁰ Mbi Vardar ka një urë me katërmëdhjetë harqe, e ndërtuar nga Fatih Sulltan Mehmeti.⁸¹ Ndërtesat monumentale të Shkupit janë Kulla e Sahatit, e lartë sa një minare, afër xhamisë së Hynqarit, me një kambanë që dëgjohej deri një ditë larg.⁸²

Sipas regjistrat të bazhdarit, në Shkup ka 70 mijë dynymë vreshta, pronë e njerëzve dhe shumë vakëfe.⁸³

Populli i Shkupit flet shqip dhe turqisht etj., me një stil të folmeje që është karakteristike për këtë qytet. Shkupi është një qytet i rregullt, me rrugë të gjera e të shtruara me gurë të bardhë dhe ka shumë pastërti.⁸⁴

Sipas Evlia Çelebiut, Kumanova është një qytet i vogël me afro 600 shtëpi të mbuluara me tjegulla, me një treg të vogël,⁸⁵ brenda të cilit ka një xhami të hijshme, ka teqe, medrese, hane e banjo, mullinj e mjaft dyqane, si

⁷⁵ Po aty, f. 122; H. Šabanović, *Putopis...*, f. 278-292.

⁷⁶ Po aty, f. 123; *Putopis...*, f. 279-292.

⁷⁷ Evlia Çelebi, *Shqipëria 350 vjet më parë (Përkthyer nga Sali Vuçiterni)*, Tiranë, 2000, f. 123.

⁷⁸ Po aty, f. 123.

⁷⁹ Po aty, f. 123.

⁸⁰ Po aty, f. 123.

⁸¹ Po aty, f. 123.

⁸² Po aty, f. 124-125.

⁸³ Po aty, f. 125.

⁸⁴ Po aty.

⁸⁵ H. Šabanović, *Putopis...*, f. 292.

dhe klimë shumë të mirë.⁸⁶ Më pas Çelebiu vazhdon rrugën një ditë në drejtim të veriut dhe mbërrin në Kratovë.

Qytetin e Novobërdës Çelebiu e përshkruan kështu: Këtë qytet e ka pushtuar Sulltani i vjetër Murad-kan II (843/ 1439-10).⁸⁷ Qyteti gjendet në ejaletin e Rumelisë në territorin e Sanxhakut të Vushtrisë dhe është i liruar nga tatimet e zakonshme dhe të tjera. Atë e administron drejtuesi i minierës së argjendit. Detyrën e ushtron me ndihmën e 100 njerëzve dhe i jep shtetit 20 barrë akçe qira.⁸⁸ Tani aty ka tri vende ku nxirret argjendi. Të dënuarit nxjerrin nga thellësitë e tokës pasurinë minerale dhe ia dorëzojnë drejtuesit të minierës. Drejtuesi në praninë e tyre e shet atë dhe të ardhurat ia dorëzon shtetit. Aty në kohën e sundimit të sulltanit Murad-kan IV ka funksionuar punëtorja e prerjes së monedhave.⁸⁹ Ka akçe nga argjendi i pastër me mbishkrimin: " Azze nasruhu, duribe fi vava Bërda " - i qoftë sundimi i lavdishëm; të shtypur në Novobërdë.⁹⁰

Si organ pushteti ka edhe kadiun me kadillëk të lartë me rang prej 150 akçe. Aty është edhe komandanti i Kalasë (dizdari) me 20 ushtarë, përfaqësuesit të spahinjve të Portës, serdari i jeniçerëve, haraç- mbledhësi, mbikqyrësi i tregut, bazhdarxhiu dhe çehajai i qytetit.⁹¹

Sa i përket qytetit të Nishit, Çelebiu pohon se Gazi Hudavendiçar në vitin 777 (1375/ 76) e pushtoi këtë qytet nga mbreti serb e bullgar Despot dhe e shëndrroi në Subashllëk.⁹²

Ky është kadillëk i rangut të kadillëqeve me 150 asyra. Nahija e tij përbëhet nga shumë fshatra përparimtare. Aty është përfaqësuesi i spahinjve të Portës, serdari i jeniçerëve, subashi, vojvoda, mbikëqyrësi i tregut, bazhdarxhiu, përfaqësuesi i sherifit, disa pari, komandanti i qytetit, por roja të qytetit nuk ka ngase kështjella e qytetit është e ndërtuar prej gurësh dhe midis qytetit si ndonjëfarë hani.⁹³ Ajo ka një portë. Pranë bodeve të qytetit janë vendosur koka të hajdutëve në shtiza të larta dhe qëndrojnë ashtu.

Xhamitë më të njohura janë: Xhamia e sulltan Muradit I në çarshi; nuk është aq e bukur, por është e ndërtuar në stil të vjetër. Xhamia e Musli efendiut; e këndshme dhe tërheqëse si pasqyra. Xhamia e Hysein qehajait

⁸⁶ Po aty, f. 292; Evlia Çelebi, *Shqipëria 350 vjet më parë (Përkthyer nga Sali Vuçiterni)*, Tiranë, 2000, f. 126.

⁸⁷ Po aty, f. 306.

⁸⁸ Po aty, f. 306.

⁸⁹ Po aty, f. 306.

⁹⁰ Po aty, f. 306.

⁹¹ Po aty, f. 306.

⁹² Po aty, f. 62.

⁹³ Po aty, f. 62.

është e shëndritshme dhe tempull mjaft i vizituar.⁹⁴ Ka disa mesxhide dhe 22 mejtepe (shkolla fillore).⁹⁵

Në qytet matanë lumit gjendet ura e Mehmed Pashës, mu në mes të asaj ure ndodhet një lokal i bukur për pushim. Në të dy skajet e urës gjendet nga një hamam i vogël që i plotëson nevojat.⁹⁶ Në çarshi ka gjithsej 200 dyqane me mallra të ndryshme dhe të shtrenjta.⁹⁷

Në disa pjesë të udhëpërshkrimit të tij ai paraqitet si njeri mjaft i guximshëm përderisa në disa raste të tjera zbulon dobësitë e veta. Siç duket, “kaçakët e Kotorrit” ia kishin futur frikën në asht.⁹⁸

Në disa vende të udhëpërshkrimit të tij na paraqitet edhe si njeri shumë fetar, por në disa të tjera tregon se si me shokët e tijë ka kaluar jetën në verime e teferiçe me shoqërinë e këngës, muzikës dhe të pijes. Por thotë se këtë e ka bërë vetëm për shkak të shoqërisë.⁹⁹

Nga e gjithë kjo që u tha më lart shihet se Evlia Çelebiu ka qenë një personalitet i veçantë. Shumë karakteristika të personalitetit të tij, janë shprehur në veprën e tij me të cilën ai ka fituar famë botërore.¹⁰⁰

Për të parë vlerën e këtij udhëpërshkrimi për shkencën është e mjaftueshme të përmendet se në bazë të të dhënave që ofron Sejahatnameja në përgjithësi mund të bëhet rikonstruktimi i rregullimit juridiko-politik, administrativ dhe ushtarak i vendit tonë¹⁰¹ nga mesi i shekullit XVII. shënimet japin një pasqyrë objektive të gjendjes për qytetet tona. Andaj, ato kanë rëndësi dhe vlerë të veçantë për historinë e tyre.

⁹⁴ Po aty, f. 63.

⁹⁵ Po aty, f. 63.

⁹⁶ Po aty, f. 64.

⁹⁷ Po aty, f. 64.

⁹⁸ Po aty, f. 64.

⁹⁹ Po aty, f. 64.

¹⁰⁰ Po aty, f. 54-55.

¹⁰¹ Po aty, f. 55.

Mr. Isuf AHMETI

KOSOVA'S TOWNS ACCORDING TO EVLIA CELEBI

Summary

Evlia Çelebi mentions in his work several towns of Kosova. According to the ottoman cadastral register of 1590, the Sanjack of Prizren had 5 nahiye: Prizren with 24 villages, Hoça with 96 and that of Bihor with 151 villages. Ottoman sources point out that the Sanjack of Prizren in 1634 and 1639 a separate sanjack. However, in 1629 and 1641 it is mentioned as a sanjack within the Elayet of Romelia. This is also mentioned in another Ottoman document from 1646. In addition, according to Ali Çausi, the Sandjack of Prizren fell in 1653 under the administration of that Elayet.

In the beginning of the 17th century (1609/10) Kosova fell administratively within two elayets: the northern part from Mitrovica to Ajuqa fell within the Eyalet of Bosnia, while the Kosova plain including Vushtrri, Prishtina, and up to Kaçanik, belonged to the Sanjack of Vushtrri within the Elayet of Romelia. Understandably, both the Sanjack of Prizren and that of Dukagjin were included in the Elayet of Romelia.